

VENDIM
Nr.10, datë 8.2.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLABINJE” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.2.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “POWER ELEKTRIK SLABINJE” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “POWER ELEKTRIK SLABINJE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. “POWER ELEKTRIK SLABINJE” sh.p.k. të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

3. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta